



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:1383/24 Datë: 12/07/2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/1-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 124-të, mbajtur me datë 25.06.2024, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e R.I.T Kosova (AUK) me nr.prot.1092/24 i datës 31.05.2024 për ndryshimin e emrit të programit Bachelor të Shkencave SOIS.
- II. Ndryshohet emërtimi i programit të studimit (titullit të diplomës), nga BSc në “Arte dhe Shkenca të Aplikuara”, në **“Program të Individualizuar”**
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

IAL R.I.T (AUK) ka parashtruar kërkesë me nr.prot.0000/24 i datës 00.06.2024 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim për ndryshimin e emrit të titullit të diplomës Bachelor të Shkencave SOIS, me arsyetimin e dhënë se ky ndryshim sipas tyre, do të ofroj fleksibilitet maksimal kurrikular për studentët në faza të ndryshme të rrugëtimit arsimor dhe se ky program karakterizohet më së miri si “i individualizuar” dhe jo si “i aplikuar.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 124-të mbajtur më datë 25.06.2024 ka shqyrtuar kërkesën e R.I.T (AUK) dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, pas administrimit të provave dhe gjendjes së vërtetuar faktike dhe juridike vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Vendimi iu dërgohet:

- R.I.T (AUK) ;
- MASHTI ;
- Arkivit të AKA-së.

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

